



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1764 Prot.

Durrës, më 08.07.2026

V E N D I M

Nr. 111, Datë 08.07.2026

P Ë R

**"NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 75, DATË
26.05.2026"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; referuar shkresës së Fakultetit të Biznesit me nr. 1761 prot., datë 08.07.2026, si dhe referuar relacionit nr. 1761/1 prot., datë 08.07.2026 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 1 të Vendimit të Senatit Akademik nr. 75, datë 26.05.2026, si më poshtë:
 - "Miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Accounting", pranë Departamentit të Financë Kontabilitetit, të Fakultetit të Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, diplomë e përbashkët me Institutin Politeknik të Bragancës", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Programi i studimit do të ofrohet në gjuhën **Angleze**.
3. Kodi i programit të studimit: **63BA0411A**.
4. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

